

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "STUDIO TARTARI" SH.P.K.**

Sot, me datë 12/01/2018,

Arvid Tartari, shtetas shqiptar, i biri i Gazmendit, lindur më 25/04/1980, në Tiranë, banues në Tiranë, Rruga Mine Peza, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. 028692013, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "STUDIO TARTARI" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1
EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "STUDIO TARTARI" Sh.p.k.

**NENI 2
SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati nr. 60, Kati I - rë, Ap. 2, (50 m prapa UET), Tiranë 1023, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.


**NENI 4
OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Studio grafike dhe imazhi; Shtëpi botuese; Shtypshkronjë; Printime Dixhitale; Realizim dhe transmetim spote audio-vizive; Shërbime këshillimi në fushën e shtypshkrimeve dhe printimeve dixhitale; Web-Design; Prodhim-menaxhim reklamash; Agjensi publicitare; Fushata mediatike si dhe veprimtari dhe sipërmarrje në fushën e publicistikës dhe mjeteve të komunimkimit masiv; Krijim dhe menaxhim faqesh interneti; Tregëtim i produkteve kancelarike për zyra dhe kompani prodhimi në fushën e shtypshkrimeve dhe printimeve; Tregëtim dhe import - eksport, instalim dhe shitje linjash dhe impiantesh tipografike të të gjitha llojeve dhe pjesë këmbimi për to, materiale ndihmëse dhe lëndë të parë për produktet tipografike; Tregëtim dhe import - eksport të mallrave, letër të llojeve për produktet tipografike.

Bashkëpunim dhe operim me shoqëri vendase dhe të huaja, për operime reciproke si nënkontraktor i operatoreve në fushën e shtypshkrimeve si dhe në aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të



përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2.000.000 (dy milion) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- *Arvid Tartari*, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.000.000 (dy milion) Lekë dhe 2.000.000 (dy milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, *Z. Arvid Tartari*, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar *Administratorin, Z. Arvid Tartari*, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

ARVID TARTARI

Arvid Tartari
